

VENDIM
Nr.558, datë 7.5.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA LIBOFSHË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Libofshë, të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 6 (gjashtë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3.Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Libofshë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave										
Komuna: Libofsh										
Fusha e përdorimit: pyje+kullota										
Nr.	Nr. i inv	Emërtesa e ekonomisë pyjore/kullosore	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërimit popullor)	Nr. i ngas.	Destinacioni	Sip. në ha.	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	4	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Argjinatura	2	bosh	1.8	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	
2	9	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Brezi Argjinaturës	4/b	bosh	21.2	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	
3	12	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Kurora e lumit	6/b	trung	3.8	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	
4	13	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Shtrati i lumit	6/c	bosh	2	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	
5	15	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Ana e lumit	6/e	shkurre	3.3	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	
6	16	ek.pyjore: Lumi Seman 2	Ana e lumit	7	trung	2.9	prodhues	M.M.P.Ad.U	D.Sh.P.Fier	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Libofshë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4, 9, 12- 13, 15,16	Pyll dhe kullotë	Pronësi